



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANE GJYKATES SE APELIT KORÇË

R A P O R T

MBI VEPRIMTARINE E PROKURORISE SE APELIT KORÇE PER PERIUDHEN 1 JANAR 2017 - 31 DHJETOR 2017

Znj. ARTA MARKU

PROKUROR I PERGJITHSHEM I REPUBLIKES

PROKURORIA E PERGJITHSHME

T I R A N E

Viti 2017 si objekt analize, eshte vit me ndryshime te medha ne kuadrin ligjor, ka qene viti kur reforma per drejtesine ka qene dhe mbetet refren i dites. Ne kete proces te rendesishem dhe jetik per drejtesine e perfshire teresisht edhe prokuroria, ne vemendjen e saj ka qene ushtrimi i funksionit ne perputhje me Kushtetuten, ligjin procedural penal dhe ate material.

Në fokus te veprimtarise dhe punes se Prokurorise se Apelit Korçe, ka qene ndeshkimi i fenomeneve shqetesuese per shoqerine shqiptare, si fenomene që mbajnë peng zhvillimin e vendit dhe shoqerise, si dhe behen pengese për procesin integrues të Shqiperise ne Bashkimin Evropian. Ne funksion të këtij qëllimi madhor, kemi synuar ne menyre te vazhdueshme rritjen e standarteve te gjykimit me nje perfaqesim cilesor te prokurorit, duke mbajtur parasysh edhe rekomandimet e Keshillit te Ministrave ne luften kunder kriminalitetit.

Ne kete konteks, Prokuroria e Apelit Korçe, ka qene ne koherence te plote te kerkesave te kohes dhe kjo materializohet me se miri ne qendrimet qe ka mbajtur.

Ne analizen qe do te bej me poshte, do te perqendrohem ne probleme te rendesishme qe lidhen jo vetem me qendrimin e prokurorit te Apelit ne raport me kerkimet e bera nga prokuroret e shkalles se pare dhe

qendrimin e gjykates, por edhe probleme te hetimit dhe gjykimit qe duhet te behen evidente me qellim qe te riparohen.

Tashme hyrja ne fuqi e ligjit procedural penal kerkon njohje dhe zbatimin e tij duke filluar nga hetimi paraprak, por edhe gjykimi ne Gjykatën e Apelit.

Ne vazhdim te ketij raportimi, fillimisht do te japim nje paraqitje me shifra te volumit te çështjeve te perfaqesuara nga Prokuroria e Apelit Korçe, per vitin 2017 dhe me pas disa probleme qe kane dale gjate gjykimit dhe shqyrtimit te çështjeve.

Keshtu volumi i çështjeve te ndjekura nga Prokuroria e Apelit Korçe eshte si me poshte :

Ne Prokurorinë e Apelit Korçe per vitin 2017, jane regjistruar gjithsej 639 çështje nga te cilat 624 çështje te reja dhe 15 te mbartura nga viti i kaluar. Ne Gjykatën e Apelit Korçe per vitin 2017, jane perfunduar 603 çështje penale me pjesmarjen e prokurorit te Apelit nga te cilat, 305 çështje themeli, 121 çështje te veçanta dhe 177 masa sigurimi (13 shuarje mase), ndersa jane mbartur 34 çështje (2 prej tyre te vecanta), per vitin 2018. Çështjet e themelit, jane shqyrtuar ne 72 raste mbi apelin e prokurorit dhe ne 337 çështje, raste mbi apelin e te pandehurit.

Te ndara sipas prokurorive qe jane ne juridiksionin e Prokurorise se Apelit Korçe:

Per Prokurorinë e Rrethit Gjyqesor Korçe jane shqyrtuar 241 çështje, nga te cilat 60 çështje mbi apelin e prokurorit dhe 277 raste mbi apelin e te pandehurit

Per Prokurorinë e Rrethit Gjyqesor Pogradec jane shqyrtuar 64 çështje nga te cilat, 12 raste mbi apelin e prokurorit dhe 60 raste mbi apelin e te pandehurit.

Ne te dhenat statistikore nuk perfshihen 121 çështje te perfunduara, te cilat ne i kategorizojme te veçanta, pasi kjo kategori nuk eshte e parashikuar ne formularet e miratuar. Por duhet te them, se keto lloj çështjesh zene nje perqindje te konsiderueshme ne veprimtarine e Prokurorise se Apelit Korçe dhe qe shpesh lidhen me probleme delikate, sic jane ato ne fazen e ekzekutimit te vendimit penal, te cilat shqyrtohen mbi apelin e paleve ne proces dhe nuk mund te neglizhohen dhe te mos jene ne dijeni te Drejtorise se Studimit prane Prokurorise se Pergjithshme. Ne Prokurorinë e Apelit Korçe ushtrojne funksionin dy prokurore, ngarkesa e çështjeve per secilen prokurore eshte si me poshte:

Prokurore Irma Balli, me cilesine e Drejtuesit te Prokurorise se Apelit Korçe ka perfaqesuar dhe perfunduar :

- 140 çeshtje themeli.
- 77 masa sigurimi.
- 50 çeshtje te tjera te kategorizuara te veçanta.
- Ka te mbartura 19 ceshtje per vitin 2018.
- Ka ushtruar 24 rekurse.
- Ka urdheruar 44 ekzekutime vendimi.

Po keshtu, ka ndjekur veprimtarine e prokurorise, me cilesine e drejtueses bazuar ne ligjin “Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne Republiken e Shqiperise”.

Prokurore Rozeta Qirjaqi ka perfaqesuar dhe perfunduar :

- 165 çeshtje themeli.
- 87 masa sigurimi.
- 71 çeshtje te veçanta.
- Ka mbartur 15 ceshtje per vitin 2018.
- Ka ushtruar 49 rekurse.
- Ka urdheruar 42 ekzekutime vendimi.

Duke krahasuar numrin e pergjithshem te çeshtjeve te regjistruara ne vitin 2017, me çeshtjet e regjistruara per vitin 2016 rezulton se ka nje rritje prej 60 çeshtjesh (ka qene 579 numri i pergjithshem i çeshtjeve vitin e kaluar).

Me poshte, po japim nje pasqyre me te hollesishme te shqyrtimit te çeshtjeve ne Gjykatën e Apelit, shkaqet e apelimeve te bera, perkrahjes se tyre dhe menyres se perfundimit ne Gjykatën e Apelit.

Per çeshtjet e themelit sqarojme si me poshte:

Ne 89 çeshtje, per te cilat eshte kerkuar mospranim ankimi, nga gjykata eshte vendosur me 89 vendime mospranim ankimi.

Ne 120 raste, per te cilat eshte kerkuar nga prokurori i Apelit lenie ne fuqi te vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare, nga gjykata ne 77 vendime eshte vendosur: lenie ne fuqi, ne 32 raste eshte lehtesuar pozita dhe ne 9 raste eshte pushuar çeshtja apo eshte dhene pafajesi dhe ne 2 raste eshte prishur vendimi dhe kthyer ceshtja per rigjykim.

Ne 42 raste, kur eshte kerkuar rendimi i pozites i te pandehurit, gjykata ne 24 raste ka vendosur lenie ne fuqi, sipas kerkimit te prokurorit te Apelit, ndersa ne 5 raste, gjykata ka lehtesuar poziten e te pandehurit, ne 2 raste

ka prishur vendimin duke pushuar çeshtjen dhe ne 1 rast eshte vendosur prishje e vendimit dhe kthimi i çeshtjes per rigjykim.

Ne 26 raste, nga prokurori i Apelit eshte kerkuar lehtesim i pozites i te pandehurit dhe nga Gjykata e Apelit ne 25 raste eshte lehtesuar pozita e te pandehurit, ndersa ne 1 rast eshte prishur vendimi dhe pushuar ceshtja.

Ne 21 raste, eshte kerkuar prishje dhe pushim çeshtje dhe ne 21 raste, gjykata ka vendosur prishje vendimi dhe pushimin e çeshtjes qe lidhen me zbatimin e ligjit per amnistine.

Ne 7 raste, eshte kerkuar prishje vendimi dhe kthimi i çeshtjes per rigjykim, nga gjykata ne 3 vendime eshte vendosur lenie ne fuqi te vendimit, ne 2 raste eshte vendosur prishje vendimi dhe kthimi i çeshtjes per rigjykim dhe ne 2 raste eshte vendosur nga gjykata, prishje vendimi dhe pushim çeshtje.

Lidhur me apelet e ushtruara nga Prokuroria e Shkalles se Pare:

Per kete vit, jane ushtruar gjithesej 72 apele, nga 47 te ushtruara vitin e kaluar. Nga keto, 40 apele nga prokuroret jane ushtruar per mase te bute denimi kryesisht per aplikimin e nenit 59 te K.Penal, 23 apele per pafajesi te dhena nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor dhe 9 apele per ndryshim te kualifikimit ligjor te vepres penale.

Apele te ushtruara nga prokuroria per vendime pafajsie:

Jane ushtruar 22 apele, per vendim pafajesie nga Prokurorite e Rrethit Gjyqesor, per te cilat:

Ne 2 raste, eshte hequr dore nga apeli i prokurorit dhe i perket çeshtjes penale me te pandehur Nevruz Tosuni, i akuzuar per vepren penale "Falsifikim i vulave, i stampave ose i formulareve", parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal dhe Dashnor Gishto, akuzuar per "Mashttrim", ne dem te disa personave, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal.

Ne 5 raste, Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimim me deklarim fajesie te te pandehurve, sipas kerkimit te prokurorit te Apelit. Çeshtjet iu perkasin te pandehurit Arti Rizo, akuzuar per vepren penale "Prodhim dhe shitje e narkotikeve", te parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal, Enver Kaftira i akuzuar per vepren penale te "Mashttrimit ne sigurime", parashikuar nga neni 146 i K.Penal, Silvana Kapri e akuzuar per vepren penale te "Mashttrimit", parashikuar nga neni 143/2 i K.Penal, Hajri Kardhiqi i akuzuar per vepren penale te "Goditjes per shkak te detyres" dhe "Mosbindje ndaj punonjesit te policise", parashikuar nga neni 237 dhe 242 i K.Penal, Jordisa Dervishi akuzuar per vepren penale te "Shperdorimit te detyres", parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Ne dy raste eshte pranuar apeli, por eshte vendosur prishje e vendimit dhe kthim i çeshtjes per rigjykim, ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor, pasi jane konstatuar shkelje me pasoje pavlefshmeri vendimi.

Ne 6 raste, eshte vendosur pushimi i çeshtjes, per shkak te ligjit “Per dhenie amnistie” dhe lidhet me vepra te lehta, per te cilat nuk duhet te vazhdohej ndjekja penale, neni 273 i K.Penal, etj.

Ne 7 raste, Gjykata e Apelit, ka lene ne fuqi vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor.

Per 3 raste, jane autorizuar prokuroret e çeshtjes, pasi Prokuroria e Apelit Korçe nuk ka qene dakort dhe ka pasur mendim te ndryshem nga çfare eshte parashtruar ne apel. Autorizimi eshte bere pasi eshte respektuar procedura e kerkuar nga Udhezimi i Prokurorit te Pergjithshem dhe Kodi i Procedures Penale. Konstatohet se ne keto raste nuk eshte pranuar kerkimi i bere nga prokurori i çeshtjes (i autorizuar) nga ana e Gjykates se Apelit, duke u lene ne fuqi vendimet e apeluara. Me ndryshimet e Kodit te Procedures Penale, ky institut nuk eshte parashikuar ne ligj.

Ne 2 raste, eshte prishur vendimi dhe eshte vendosur prishje vendimi dhe kthim per rigjykim.

Per te gjitha çeshtjet, qe nuk jane pranuar nga gjykata dhe kane qene shkaqet ligjore te parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, tashme edhe te ndryshuar, eshte ushtruar rekurs, per te cilat nuk kemi marre pergjigje.

Apele te ushtruara nga prokuroria, per vendime me ndryshim te kualifikimit ligjor te vepres penale.

Jane ushtruar 9 apele, per ndryshim te kualifikimit ligjor te vepres penale nga te cilat :

Ne 5 raste, Gjykata e Apelit ka lene ne fuqi vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor.

Ne 2 raste, eshte ndryshuar vendimi sipas kerkimit te bere nga prokurori i Apelit me rendim te pozites te te pandehurve dhe i perkasin çeshtjeve me te pandehur Veli Kolneku, i akuzuar per vepren penale te “Dhunes ne familje”, per te cilen, gjykata e kishte ndryshuar kualifikimin ne “Plagosje te lehte” dhe Jorgjeta Renxa, e akuzuar per vepren penale “Mashtrimi”(me pasoja te renda), parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal.

Ne 1 rast, gjykata nuk e ka lehtesuar poziten e te pandehurit, pasi çeshtja vinte me apel te paleve ne proces dhe i perket te pandehurit Fabio Mucelli, i akuzuar per “Vrasje”, sipas nenit 78 te K.Penal.

Ne 1 rast, nga prokuroria eshte hequr dore nga apeli i prokurorit te çeshtjes, pasi pretendimet e tij per ndryshimin e vepres penale nga “Vjedhje e thjeshte” ne “Vjedhje me dhune” nuk qendronin, kjo çeshtje lidhet me te pandehurin Vasil Kello.

Apele te ushtruara nga prokuroria, per vendime me mase denimi te bute.

Ne pergjithesi, apelet me kete objekt jane ushtruar per te ndryshuar alternativen e pezullimit te denimit me burgim dhe masen e denimit qe ka qene relativisht e ulet.

Ne pergjithesi, ato kane qene te lidhura me kryerjen e vepres penale te parashikuar nga neni 291, neni 273, 199 i K.Penal, te ndryshuar dhe prokuroria e ka mbeshetur denimin me burgim per te qene koherente me politiken e ashper te denimit qe orientohet ne keto raste.

Te njejten qendrim, ka mbajtur edhe per “Dhunen ne familje”, i parashikuar nga neni 130/a i K.Penal.

Jane ushtruar 40 apele, per te ndryshuar masen e denimit, shumica, per te mos thene te gjitha rastet jane te lidhura me alternativat e denimit.

Ne 11 raste, eshte vendosur mospranim i ankimit, nga te cilat, ne 8 raste eshte hequr dore nga apeli i prokurorit, per te cilen eshte respektuar kuadri ligjor, marredhenia me Prokurorine e Shkalles Pare dhe Drejtorine e Gjyqesorit prane Prokurorise se Pergjithshme. Heqja dore nga apeli, eshte bere per rastet e aplikimit te nenit 59 te K.Penal dhe per vepra te lehta. Ne 3 raste, apeli ishte ushtruar nga prokurori i rrethit, i cili sipas Kodit te Procedures Penale, nuk legjitimohej te ushtronte apel.

Ne 4 raste, eshte ndryshuar vendimi duke u ashpersuar masa e denimit, dhene nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor.

Ne 3 raste, duke qene se vendimi ishte apeluar nga dy palet ne proces, gjykata ka lehtesuar poziten e te pandehurit.

Ne 4 raste, eshte vendosur pushimi i çeshtjes. Nje prej tyre eshte pushuar, pasi i pandehuri kishte vdekur. Ne 3 rastet e tjera, çeshtjet lidhen me plotesimin e formulareve te dekriminalizimit, bazuar ne ligjin 138/2015 “Per dekriminalizimin”, per te cilin, jo vetem mendimi dhe vendimet e Gjykates se Apelit, por edhe diskutimi ne rradhet e prokuroreve eshte i ndryshem, lidhur me pergjegjesine penale te subjektit.

Megjithate, çeshtjet jane rekursuar nga ana jone dhe presim se si do te silllet Gjykata e Larte ne keto raste.

Ne 2 raste, eshte zbatuar ligji “Per dhenie amnistie”.

Ne 15 raste, eshte lene ne fuqi vendimi i Gjykates se Rrethit Gjyqesor i apeluar nga prokurori.

Ne te gjitha çeshtjet, kur kane qene shkaqet ligjore te parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, eshte ushtruar rekurs ne Gjykatën e Larte.

Lehtesim i pozites se te pandehurit vendosur nga gjykata:

Ne 68 çeshtje te apeluara nga te pandehurit, Gjykata ka vendosur lehtesim te pozites, me zbutje denimi apo deklarim te pafajshem.

Ne rast se shihet pasqyra e çeshtjeve (sipas pasqyrave te statistikes), per kete ndryshim zbutja e denimit lidhet me kryerjen e vepres penale te drejtimit te automjetit ne menyre te parregullt, ndertim i paligjshem dhe eshte vendosur aplikimi i nenit 59 te K.Penal.

Ne 13 raste, nga Gjykata e Apelit eshte ndryshuar vendimi dhe eshte dhene pafajesi ose pushuar çeshtja .

Nga Prokuroria e Apelit Korçe, eshte ushtruar rekurs ne te gjitha rastet kur eshte vleresuar zbatimi i keq i ligjit material apo procedural, nga ana e Gjykates.

Nga 68 rastet, ne 26 prej tyre, prokurori ka qene per zbutje te denimit qe lidhen me vepra te lehta dhe kur kane qene kushte per aplikimin e nenit 59 te K.Penal apo nenit 63 te K.Penal.

Ne 7 raste (çeshtjet te shqyrtuara mbi apelin e te pandehurit) nga prokurori i Apelit, per shkelje te ligjit procedural penal, me pasoje pavlefshmeri vendimi apo mosarsyetim vendimi nga Gjykatat e Rrethit Gjyqesor, eshte kerkuar prishje vendimi e kthim çeshtje per rigjykim. Ne pergjithesi, ato lidhen me çeshtje te shqyrtuara ne Gjykatën e Apelit, mbi apelin e prokurorit.

Po keshtu, ne 21 raste, prokuroria ka kerkuar pushimin e çeshtjes per shkak te ligjit “ Per dhenie amnistie”.

Gjate shqyrtimit te çeshtjeve te themelit, Prokuroria e Apelit Korçe ka pasur piksynim paraqitjen me cilesi te konkluzioneve, si ne rastet kur eshte kerkuar lenie ne fuqi te vendimit, por sidomos ne çeshtjet ku eshte dhene pafajesi dhe eshte argumentuar e kunderta apo edhe ne rastet kur eshte kerkuar ndryshim i kualifikimit ligjor. Konkluzioni eshte se ne pergjithesi, apelet e ushtruara nga Prokurorite e Shkalles se Pare kane qene ligjore dhe jane mbeshtetur nga ana jone, por ka vend per te ndryshuar. Shpesh here, apelet jane bere objekt i diskutimit me prokuroret per menyren e formulimit, problemin e ushtruar per zgjidhje, apo per te plotesuar ate, sipas nenit 415 te K.Pr.Penale, sepse konstatohet se apeli ushtrohet nga prokuroret pa u njohur me arsyetimin e vendimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor.

Plotesimi i kesaj kerkese behet imediate me ndryshimet e Kodit te Procedures Penale, e pikerisht neni 425 i K.Pr.Penale, mbi “Kufijte e shqyrtimit te çeshtjes”, qe do te thote Gjykata e Apelit shqyrton çeshtjen mbi shkaqet e ngritura ne apel.

Po keshtu, gjithmone ne kendveshtrimin e ndryshimeve procedurale lind çeshtja e vendimeve me deklarim te pafajshem te te pandehurve.

Shqyrtimi gjyqesor bazuar ne nenin 427 te K.Pr.Penale eshte domosdoshmeri qe ne fakt Gjykata e Apelit, nuk e aplikon sidomos ne gjykimet e zhvilluara sipas institutit te gjykimit te shkurtuar.

Mendoj qe gjykimi i çeshtjeve, ne te cilat i pandehuri bashke me kerkimin per gjykimin e çeshtjes sipas ketij lloj gjykimi, kerkon deklarimin e pafajshem te tij, te mos mbeshtetet nga ana e prokurorise dhe me pas te ushtrohet apeli per kete vendim te ndermjetem.

Bazuar ne rekomandimet e Keshillit te Ministrave dhe udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem konstatohen kerkesa te pakta te prokurorise per gjykime te drejtperdrejta, sidomos per çeshtjet ku hetimi perfundon brenda kohes se “arrestit ne flagrante” dhe lidhet me çeshtje fakti.

Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar, prandaj për të patur sukses në luftën kundër kriminalitetit është e nevojshme të kryhen hetime të shpejta dhe efikase, por edhe nje gjykim brenda nje afati sa me te shkurter dhe arsyeshem.

Ne respektim te ketij parimi, Prokuroret e Apelit kane respektuar afatet ligjore te gjykimit te çeshtjes duke mos u bere pengese ne asnje rast, per shtyrjen e gjykimit te çeshtjes ne Gjykatën e Apelit .

Apelet e ushtruara nga ana e prokurorise per masen e denimit dhe qe lidhen me vepra te renda penale te: korrupsionit, krimet ekonomik e financiar, te prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, veprat penale kundër mjedisit dhe ndërtimit të paligjshëm; kane qene te bazuara dhe jane mbeshtetur nga prokuroria, por nje pjese e apeleve e sidomos per aplikimin e alternativave te denimit me burgim jane te tepruara, sidomos per vepra te lehta dhe persona jo problematike ne shoqeri. Por tashme, mesazhi qe ka ardhur nga gjykata eshte se personat, qe kryejne vepra te lehta per here te pare, jane te parrezikshem per shoqerine, ndaj tyre jane aplikuar alternativa te denimit, siç jane venia ne prove, neni 59 i K.Penal apo puna ne interes publik, neni 63 i K.Penal. Aplikimi i alternativave te denimit duhet pare me perparesi kur jane kushtet. Kjo vjen edhe si kerkese e kohes se Rekomandimeve te Keshillit te Ministrave, qe orienton se: ***Zbatimi i masave alternative të dënimit, ndaj personave me rrezikshmëri të ulët shoqërore, që kryejnë vepra penale me masë dënimi në maksimum deri 5 vjet burgim, por edhe e standarteve te referuara. Me kete rast citoj: Sipas standarteve nderkombetare perdorimi i burgimit si forme denimi duhet kufizuar rreptesisht dhe te jete extrema ratio, ne raste te veçanta atehere kur nuk mund te zbatohen masa te tjera te pershtateshme. Siç shprehet Keshilli i Evropes, burgimi duhet te zbatohet si mase vetem kur çdo mase apo sanksion tjeter do te ishin te papershtateshme, per rendesine e vepres dhe duhet te behen perpjekje qe te minimizohet perdorimi i masave qe privojne personin nga liria dhe te zbatohen me shume ato te cilat nuk e bejne kete.***

Ketu shtoj faktin se aplikimi i alternativave te denimit eshte bere pjese diskutimeve edhe ne tryeza te vazhdueshme te organizuar nga Ministria e

Drejtësisë, me praninë e asistencës ndërkombëtare. Mesazhi që vjen është: *Aplikimi i alternativave të denimit, kur burgimi është mjet i papërshtatshëm në raport me rëndësinë e faktit dhe rrezikshmerinë e autorit.*

Ndryshe trajtohen personat shoqërisht të rrezikshëm, apo persona që kryejnë vepra penale për të cilat shoqëria është e ndjeshme (këtu kam parasysh: dhunë në familje apo dhe në ambiente publike, vrasjet, veprat penale që lidhen me drogën e ndryshme, korrupsionin, etj.). Apelet e ushtruara nga prokurorët mbështeten, por edhe në rastet kur nga gjykata është lehtësuar pozita e të pandehurit me ulje të denimit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Në këtë aspekt, denimi bëhet çështje kur subjekti është i mitur. Kodi për të miturit ka sjellë ndryshime, në të cilat vec faktorit prokurorin dhe gjykatën, kërkon praninë e aktoreve të tjerë në shërbim të dhenies së drejtësisë apo dhe interesit me të lartë të femijes.

Per çështjet e kategorizuara të veçanta rezultojnë se :

Jane perfunduar 121 çështje të kategorizuara të veçanta ku përfshihen çështje penale me objekt vendim pushimi, mosfillimi, lirim me kusht, çështje që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimit apo çështjet e ngritura për probleme të zbatimit të ligjit “Për dhenie amnistie” etj.

Në këto lloje gjykimesh, sidomos në ato çështje që lidhen me vendimet e pushimit dhe të mosfillimit, Prokuroria e Apelit Korçë është udhëhequr nga parimi : *Që çështja duhet të hetohet në teresi, hetimi si detyrim kushtetues i Prokurorisë duhet të jetë i plotë dhe vendimmarrja të jetë sa më objektive duke pasur parasysh që shpesh vendimi i pushimit prek interesat e kërkuarve si dhe mosfillimi të vendoset kur janë të pranishme kërkesat e nenit 290 të K.Pr.Penale.*

Po tashmë, me ndryshimet procedurale, hetimi paraprak kontrollon nga gjykimi dhe çështjet që kanë objekt vendimet e pushimit, në Gjykatën e Apelit zgjidhen në dhomen e keshillimit.

Çështjet që lidhen me të demtuarin akuzues, procesi është orientuar sipas nenit 59 të K.Pr.Penale dhe prokurori ka ushtruar funksionin brenda kufijve të parashikuara nga kjo dispozitë, por gjithmone me një rol aktiv për të dhënë mendim, lidhur me fajësinë e të akuzuarit, në vlerësimin e provave të paraqitura nga palët në proces, apo dhe në dënimin e mendimit për masën e denimit.

Çështjet me objekt “Lirim me kusht”, bazuar në nenin 64 të K.Penal, janë të shpeshta në Gjykatën e Apelit, kryesisht të apeluara nga të dënuarit.

Në këto lloje gjykimesh, prokurorët janë treguar të kujdesshëm jo vetëm në respektim të kërkesave të nenit 64 të K.Penal, por edhe në respektim të vendimit unifikues nr. 2, të vitit 2015 të vendosur për këtë objekt.

Problemi ka lindur lidhur me zbatimin e ligjit “Per dhenie amnistie”, nr. 154, te vitit 2015, sidomos me piken “c” te nenit 3 dhe nenin 4 te ketij ligji. Qendrimet kane qene te ndryshme, por mendimi i prokurorit ne te dy shkallet e gjykimit, eshte orientuar nga mendimi i Prokurorise se Pergjithshme, bazuar ne shkresen nr.343/1, dt 03.04.2016. Nga Gjykata ne keto raste nuk jemi mbeshtetur dhe te gjitha ceshtjet jane ankimuar me rekurs ne Gjykatën e Larte. Rezulton se tashme eshte dhene vendim lidhur me kete ceshtje. Jane pranuar rekursët e ushtruara nga ana jone, lidhur me menyren e zbatimit te nenit 3 dhe 4 te ligjit te siper cituar duke u pranuar logjika dhe kerkesa e prokurorit. Permendim ketu ceshtjen e Jani Kovacit dhe Adriatik Hysenit.

Çeshtjet me objekt caktim mase sigurimi.

Viti qe analizohet ka pasur nje ulje te shqyrtimit te masave te sigurimit. Kete vit, jane regjistruar 164 masa sigurimi, nga 218 qe jane regjistruar vitin e kaluar.

Jane shqyrtuar dhe perfunduar gjithesej 164.

Masat e sigurimi ne 21 raste, jane shqyrtuar mbi apelin e prokurorit dhe ne 146 raste mbi apelin e shtetasit nen mase sigurimi.

Ne 24 raste, eshte kerkuar nga prokurori i Apelit per ndryshim te mases se sigurimit, nga te cilat 15 raste per mase me te rende sigurimi “Arrest ne burg” dhe 9 raste per mase me te bute sigurimi. Ne 2 raste jane pranuar nga Gjykata e Apelit duke vendosur masa e “Arrestit ne burg”, ne 8 raste eshte pranuar kerkimi i prokurorit duke u vendosur mase me te bute sigurimi, ndersa 14 raste nuk eshte pranuar kerkesa e prokurorit nga Gjykata e Apelit Korçe, duke u miratuar vendimi i Gjykeses se Rrethit Gjyqesor.

Ne 127 raste, eshte kerkuar miratim vendimi te mases se sigurimit te vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korçe; ne 80 raste eshte miratuar vendimi nga Gjykata e Apelit; ne 43 raste eshte ndryshuar masa e sigurimit “Arrest ne burg”, ne nje mase sigurimi me te bute, ndersa ne 4 raste eshte shfuqizuar vendimi.

Ne gjykimet me kete objekt, Prokuroria e Apelit Korçe orientohet ne zbatimin me korrektesi jo vetem te nenit 228 e 229 te K.Pr.Penale, por sidomos te kerkesave te nenit 230 te K.Pr.Penale, lidhur me kriteret e veçanta te “Arrestit ne burg”. Megjithate duhet te tregohet kujdes ne aplikimin e kesaj mase sigurimi. Duhet te aplikohet masa e sigurimit “garanci pasurore”, e cila mund te them qe eshte e rralle. Si rekomandon Keshilli i Ministrave, ***kërkesa për masën e sigurimit “Arrest në burg” për të miturit, të jetë rast përjashtimor dhe në rastet kur ajo kërkohet/vendoset, duhet që hetimet të përfundojnë në kohën më shkurtër të mundshme;***

Ashpërsim të masës së sigurimit/dënimit ndaj personave me rrezikshmëri të madhe shoqërore dhe për vepra penale që parashikojnë masë dënimi në minimum mbi 5 vjet burgim;

Mendoj që në kerkimet për masën e sigurimit “Arrest në burg”, prokuroria duhet të jetë e kujdesshme, sepse kjo masë nuk mund të bëhet pafund prioritare në raport me masat e tjera të sigurimit edhe për vepra të lehta.

Ligji procedural penal ka ndryshime dhe në kapitullin që trajton masat e sigurimit dhe kujdesin që duhet të tregohen sidomos me masën “Arrest në burg” si me informacionin që prokurori duhet të dergojë përpara gjyqates, veprimet e shpejta që duhet të kryhen për perfundimin e çështjes apo edhe afatet e dergimit në gjykatë në rastet e ankimit të ushtruar ndaj tyre.

Nga Prokuroria e Apelit Korçë, kanë dalë 86 Urdhëra ekzekutimi të vendimeve penale, të urdhëruara menjëherë nga Gjykata e Apelit.

Nga Prokuroria e Apelit Korçë, janë ushtruar 73 rekurse që lidhen me pafajësi, ndryshim kualifikimi, masë dënimi apo masa sigurimi.

Nga ana e prokurorisë, për natyrën e veprimtarisë së saj, ka një bashkëpunim mjaft të mirë korrekt me Prokuroritë e Rrethit Gjyqësor dhe Policinë Gjyqësore pranë saj. Ky bashkëpunim është i domosdoshëm për një zgjidhje të drejtë dhe ligjore gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit. Kjo kushtëzon një komunikim permanent në marrjen e akteve të ndryshme, fashikullit të prokurorit, marrjen e provave shtese kur çëlet shqyrtimi gjyqësor, apo edhe për fazën e ekzekutimit. Në këtë moment, dua të ve në dukje ndryshimin në ligjin penal për mënyrën e ekzekutimit të dënimit me burgim nën 59 të K.Penal. Ekzekutimi vëhet menjëherë pas shpalljes së vendimit dhe kjo kërkon që zyra e ekzekutimit të vendimit penal të jetë operative dhe të veprojë në kohën e duhur që dënimi të jetë sa më efektiv.

Në çdo moment, Prokuroria e Apelit Korçë, ve në dijeni Prokurorinë e Rrethit (drejtuesin apo dhe prokurorin e çështjes) për mënyrën e perfundimit të çështjeve, sidomos ato të ndjekura mbi apelin e prokurorit. Mbarevajtja e veprimtarisë së Prokurorisë së Apelit Korçë, lidhet edhe me një bashkëpunim të mirë me Gjykatën e Apelit, sidomos për momentin e marrjes së dosjes për studim apo venies në dispozicion të prokurorëve, shkurtimin e vendimit për momentin e ekzekutimit të menjëhershëm.

Në Prokurorinë e Apelit Korçë, gjatë vitit 2017 janë përmbushur të gjitha shpenzimet e parapercaktuara në projekt-buxhetin e vitit 2017, që përfshijnë zërat: paga, sigurime shoqërore dhe shpenzimet operative.

Korrektësia dhe disiplina financiare kanë qënë në nivel shumë të lartë në mënyrën e administrimit sa më eficient të shpenzimeve.

Konstatohet bashkëpunim efektiv me Drejtorinë Ekonomike pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Disiplina ne pune shihet si nje element qe ndikon ne veprimtarine e Prokurorise se Apelit Korçe, e cila respektohet nga te gjithë punonjesit. Po keshtu, Kodi i Etikes dhe rregullat e vendosura prej tij, jane ne vemendje te prokuroreve dhe punonjesve te tjere te Prokurorise dhe respektohen maksimalisht.

Faleminderit!

PROKURORE E APELIT
Irma BALLI